



DR. IRIS ALLAJBEU
MJEKE RADIOLOGE
Shefe e Departamentit të Imazherisë së
Avancuar pranë Spitalit Amerikan Tiranë

Kontrolli i rregullt me mamografi dhe Rezonancë Magnetike si dhe kontrolli fizik periodik i gjirit nga një mjek specialist është metoda më e mirë e provuar për reduktimin e vdekjeve të grave nga kanceri i gjirit.

- **Kanceri i gjirit shkakton numrin më të madh të vdekjeve të grave sot në botë.**
- **Kanceri i gjirit ka incidencën më të lartë se gjithë llojet e tjerë të tumoreve.**
- **Cdo vit, në botë, rreth 190.000 gra preken nga kanceri i gjirit dhe 42.000 prej tyre vdesin.**
- **Kanceri i gjirit është një sëmundje që mund të kurohet nëse kapet në fazat e tij të hershme.**

KUR ËSHTË KOHA MË E MIRË PËR EKZAMINIMIN E GJIRIT?

Duke qënë se gjiri është një organ mjaft i ndikueshëm nga hormonet gjatë ciklit menstrual koha më e përshtatshme për ekzaminimin e tij është ndërmjet ditëve 7-17 të ciklit menstrual ose javën menjëherë pas periodave kur gjinjtë janë më të butë dhe më pak të ndjeshëm por duhet patur parasysh se të gjitha metodat diagnostikuese janë të varura shumë nga eksperiencia e radiologut dhe nga cilësia e aparaturave dhe ekzaminimit.



E shtuna Vital

nga  American Hospital



METODAT IMAZHERIKE të diagnostikimit të gjirit

1 - MAMOGRAFIA

Është një ekzaminim radiografik specifik për gjirin me dozë të ulët rrezatimi që përdoret gjerësisht si metodë depistuese për diagnostikimin e hershëm të kancerit të gjirit.

Ky ekzaminim rekomandohet për depistimin vjetor të grave duke filluar nga mosha 40 vjeç. Kërkime të shumta kanë treguar se depistimi vjetor me mamografi çon në kapjen e hershme të kancerit të gjirit kur ai është plotësisht i kurueshëm pa nevojën e mastektomise radikale (heqjes totale të gjirit).

Mamografia është e vetmja metodë për diagnostikimin e mikrokalçifikimeve në gjiri që janë shënja e parë e kancerit të gjirit. Doza e rrezatimit që merret në mamografi është minimale dhe ekuivalente me atë që marrim nga ambienti gjatë 3 muajve. Me aparaturat dixhitale moderne kjo dozë është pakësuar në minimum.

Mamografia përdoret edhe për qëllim diagnostikimi në rastet kur pacienti ka një patologji të dyshimtë për vlerësim të mëtejshëm, nese është një lezion me natyrë jokancerogjene që nuk përbën problem apo është një patologji kancerogjene që ka nevojë për studime të mëtejshme si Rezonancë Magnetike apo biopsi.

Dy janë patologjitë kryesore që diagnostikohen në mamografi:

- **Kalçifikimet:** Depozitime të vogla të kalçiumit në gjiri nga të cilat ka dy tipe:

- **Makrokalçifikime:** Shkaktohen nga një sërë patologjish jo kancerogjene, diagnostikohen në 50% të grave dhe nuk përbëjnë rrezik.

- **Mikrokalçifikimet:** Mund të jenë shenja e parë e kancerit të gjirit. Jo të gjitha mikrokalçifikimet janë kancerogjene. Forma dhe vendosja e tyre kanë shumë rëndësi. Në shumicën e këtyre rasteve rekomandohet një kontroll mamografik pas 3-6 muajsh. Kur dyshimi është i lartë nevojitet heqja dhe biopsia e tyre.

- **Masa është një gjetje tjetër në mamografi.** Ajo mund të jetë kancerogjene dhe në rast të tillë nevojiten ekzaminime të tjera si Rezonancë Magnetike apo biopsi, ose me natyrë të mirë, si kist apo fibradenome.

Kur masa e diagnostikuar në mamografi është me natyrë të mirë rekomandohet një rikontroll mamografik pas 6-12 muajsh.

2 - EKOGRAFIA E GJIRIT

Është një metodë dinamike për vlerësimin e gjirit mbi bazën e ultratingujve që përfton pamje reale dhe që përdoret për vlerësimin e një sërë patologjive të gjirit të diagnostikuara nga mjeku apo vetë pacienti gjatë ekzaminimit fizik të gjirit si dhe për të sqaruar një sërë patologjish të detektuar në mamografi.

Kjo metodë është e përshtatshme për të gjitha moshat pasi nuk përmban rrezatim.

Ekografia ndihmon në diferencimin e lezionit nëse është solid apo kistik (me përmbajtje të lëngët) si dhe benign (i parrezikshëm) apo malinj (kanceroz) dhe përdoret gjithashtu edhe si ndihmë në biopsinë e gjirit.

Ekografia e gjirit në rutinë nuk përdoret për depistimin e kancerit të gjirit. Ajo më tepër gjen përdorim në vlerësimin e problemeve të gjirit të diagnostikuara në ekzaminim fizik apo në mamografi. Por rekomandohet për depistim vetëm në moshat e reja apo me gjinj të forte (me përmbajtje kryesisht fibroglandulare) si dhe në gratë shtatzëna.

Megjithëse një metodë e thjeshtë dhe joinvazive, ekografia e gjirit është një ekzaminim subjektiv që varet shumë nga eksperiencia e radiologut dhe është më pak sensitive se Rezonanca Magnetike në diagnostikimin dhe diferencimin e sëmundjeve.

tjetër duke i dhënë informacion shumë të vlefshëm kirurgut për të planifikuar llojin e procedurës kirurgjikale që duhet të ndiqet.

RM është aprovar si metoda më e mirë për ndjekjen pas ndërhyrjes të pacientëve me kancer të gjirit pasi diagnostikon me saktësi tumorin residual (të mbetur nëse ka) si dhe frekurencat e mundshme.

RM është metoda e preferuar për vlerësimin e gjinjve të fortë dhe implanteve të gjirit ku mamografia ngelet e pamjaftueshme, është e sigurt për të gjitha moshat dhe për gratë shtatzëna pasi nuk përmban rrezatim.

Këtu vlen të përmendet se me gjithë përdorimin e gjerë të aparaturave të Rezonancës Magnetike sot, RM e gjirit është një ekzaminim shumë specifik që kërkon aparatura dhe programe të posaçme me teknologji moderne dhe vlerësimin e një radiologu specialist për të arritur rezultate optimale dhe në vendin tonë aplikohet aktualisht vetëm në Spitalin Amerikan të Tiranës.



Rezonanca Magnetike është metoda e fundit joinvazive në imazherinë e gjirit që përdoret për diagnostikimin e një sërë patologjive në rastet kur ekografia apo mamografia ngelen të pamjaftueshme.

Shoqata Amerikane e Kancerit për diagnostimin e hershëm të kancerit të gjirit rekomandon:

- Gratë në moshën 40 vjeç dhe sipër duhet të bëjnë kontroll mamografik vjetor. Studimet e fundit tregojnë se kontrolli vjetor mamografik po rrit gjithnjë e më shumë diagnostikimin e kancerit të gjirit në fazat e para kur është plotësisht i kurueshëm.

Megjithatë mamografia ka kufijtë e saj sepse jo çdo kancer është i diagnostikueshëm me mamografi. RM kohët e fundit është kthyer në një metodë diagnostikuese shumë premtuese për detektimin e hershëm të kancerit të gjirit. Shoqata Amerikane e Kancerit të gjirit rekomandon:

- Gratë me risk të lartë (>20%) për kancerin e gjirit duhet të kryejnë cdo vit Rezonancë Magnetike të gjirit krahas mamografisë. Ky grup përfshin:

- Gratë me histori të kancerit të gjirit në familje (nëna, motra apo vajza)

- Gratë që kanë marrë radioterapi të krahavorit në moshat 10-30 (psh për trajtimin e limfomës)

- Gratë me gen pozitiv të kancerit të gjirit, BRCA1 apo 2

- Gratë me sindroma në familje si Li-Fraumeni, sindroma Cowdwn etj

- Gratë me risk të moderuar duhet të konsiderojnë gjithashtu depistimin vjetor me RM krahas mamografisë. Këto përfshijnë:

- Gratë me histori kanceri në fazat e hershme si DCIS, LCIS, apo të diagnostikuara me patologji prekancerogjene si hipërplazi atipike duktale apo lobulare.

- Gratë me gjinj të fortë me përmbajtje të theksuar fibroglandulare që vështirësojnë vlerësimin mamografik.

3 - REZONANCA MAGNETIKE E GJIRIT

Është metoda e fundit joinvazive në imazherinë e gjirit që përdoret për diagnostikimin e një sërë patologjive në rastet kur ekografia apo mamografia ngelen të pamjaftueshme, për depistimin e grave me risk të lartë dhe të moderuar, si dhe në vlerësimin para dhe pas ndërhyrjeve të kancerit të gjirit.

RM arrin të detektojë kancerin e gjirit që në fazat e para kur nuk është i dukshëm me mamografi apo eko prandaj rekomandohet si metodë depistimi për gratë me rrezik të mesëm dhe të lartë për kancerin e gjirit

RM e gjirit rekomandohet sidomos në vlerësimin para ndërhyrjes kirurgjikale të kancerit të gjirit pasi përçakton me saktësi lokalizimin, dimensionet e tumorit, vatra të tjera kanceroze në të njëjtin gjiri apo në gjirin